



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 24.10.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Glauk Konjufca, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Jelena Bontiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Agim Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Rinor Beka- NDI, Behxhet Shala –KLMDNJ ,Florije Kika-AKKVP, Blend Zyrapi- KIPRED, Violeta Haxholli- KDI, Egzon Osmanaj- OSBE, Jasin Zeqiri-KosovaPress, Gëzim Shala-IKD/BPD, Kaltrina Zymberi-Ekonomia Online, Dren Ajeti-GLPS dhe Blerta Bejtullahu- Eu Office.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.10.2017;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/-L004 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;
4. Diskutim lidhur me zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Prokurial të Kosovës;
5. Shqyrtimi raportit vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2016;
6. Të ndryshme.

Kryetarja propozoi që si pikë e parë rendit të ditës të shqyrtohet Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës për Vitin 2016. Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.10.2017

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin, e mbledhjes së mbajtur më 10.10.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi raportit vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2016

Kryetarja fjalën ia dha u. d. të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës znj. Florije Kika që të paraqesë para Komisionit Raportin Vjetor për Vitin 2016.

Florije Kika paraqiti para Komisionit punën njëvjeçare të Agjencisë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronës për vitin 2016. Rreth këtij raporti kishte pyetje dhe shqetësime që u ngritën nga anëtarët e Komisionit. **Diskutimet e plota janë të paraqitura në transkriptin e datës 24.10.2017.**

Pas diskutimeve me gjashtë vota “**për**” dhe “**tre**” vota kundër komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu